



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1228/4 prot.

Datë 04.07.2022

**V E N D I M**

**Nr. 626/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga nga BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-19269-02-09-2022, me objekt Loti 2 “Blerje Naftë (Eurodiesel), me fond limit 72,114,844 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 25.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë ShA.

**Ankimues:** BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA  
Rruga “Ali Demi”, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Ujësjiellës Kanalizime Tiranë ShA.  
Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*.”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.02.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-19269-02-09-2022, me objekt Loti 2 “Blerje Naftë (Eurodiesel), me fond limit 72,114,844 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 25.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë ShA.

II.2. Në datën 25.03.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 05.04.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- Gega Center GKG& Gega Oil	69,397,486	I skualifikuar
- A&T&Olsi&2A2F-L Oil	71,998,832	I kualifikuar
- Europetrol Durrës Albania	72,114,000	I skualifikuar

II.4. Në datën 05.04.2022 BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- *Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” sh.a me vlerë 69,397,486 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSh. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021” Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar neni 82 si dhe dokumenteve të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomikë nga të cilët rezultoi si më poshtë vijon: Së pari në kriteret e përgjithshme të kualifikimit është kërkuar si më poshtë vijon: Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet : Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike KVO vëren se operatori ekonomik Gega Center GKG në seksionin e sistemit elektronik “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” ka përzgjedhur operatorin ekonomik “Gega Oil Group” sh.a. Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatorët ekonomikë kanë paraqitur kontratë bashkëpunimi si dhe janë krijuar si bashkim operatorësh ekonomikë datë 10.05.2021, nr.rep 3243, nr.kol 1374 si dhe kanë paraqitur prokurë të posaçme nr.rep 3242, nr.kol 1373, datë 10.05.2021. Referuar marrëveshjes të bashkëpunimit të sipërcituar përkatësisht neni 11 deklarojnë se shoqëritë do të hyjnë në të gjitha procedurat e tenderimit që do të zhvillohen në Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj të cilët kanë të bëjnë me furnizime karburanti, naftë, benzinë shoqëritë kanë ndarë pjesëmarrjen në 80% për shoqërinë “Gega Center GKG” si dhe 20% për shoqërinë “Gega Oil Group” sh.a. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se marrëveshja e bashkëpunimit është e përgjithshme ku nuk është përcaktuar as procedura e prokurimit për të cilën lidhet kjo marrëveshje, as autoriteti kontraktor. Theksojmë se ky dokument është i lidhur në përgjithësi (nënvizojmë) palët bien dakord që ky bashkim operatorësh ekonomikë të marrë pjesë në çdo procedurë tenderi që do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj si dhe është përcaktuar ndarja e pjesëmarrjes në raportin 80% për Gega Center GKG dhe 20% për shoqërinë Gega Oil Group sh.a. Në udhëzimet e përcaktuara në DST-në objekt prokurimi seksioni 1 parashikohet... Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE): 2.1. të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare; 2.2. BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës. b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës. Në dokumentet e tenderit shtojca 7, Formular i kriterëve të përzgjedhjes nga AK(sipas formatit të miratuar nga APP) është*

kërkuar.... Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet : Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. Në kreun XI , neni 88 në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë parashikohet.... 1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 3. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës Gega Center GKG& Gega Oil Group sh.a nuk kanë paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit në lidhje me kontratën e bashkëpunimit, më të gjitha elementët e nevojshëm për një procedurë prokurimi duke dhënë detaje të rëndësishme si në lidhje me Autoritetin Kontraktor, objektin e prokurimit. Akoma më tej ju bëjmë me dije se ligji në fuqi për prokurimet ka lehtësuar operatorët ekonomikë në përgatitjen e dokumentacionit edhe në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Përkatesisht në nenin 88 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 e ndryshuar përcaktohet që kontrata e bashkëpunimit hartohet ndërmjet palëve pra pa nevojën e domosdoshme për tu hartuar zyrtarisht pranë një noteri publik. Për sa cituam më lart gjatë kohës të publikimit të procedurës të prokurimit në sistemin e prokurimeve keni pasur të gjithë kohën e nevojshme për të krijuar një kontratë bashkëpunimi për Autoritetin Kontraktor UKT sh.a si dhe për objektin e prokurimit të hartuar ndërmjet shoqërive tuaja respektive pa nevojën e zyrtarizimit të kontratës të bashkëpunimit para një noteri publik. Gjithashtu ju bëjmë me dije se skualifikimi për shkak se është paraqitur kontratë e përgjithshme në rastin tuaj konkret krijuar shumë kohë më parë (10.05.2021) se data e zhvillimit të tenderit, pa u përcaktuar as Autoriteti Kontraktor, as objekti i prokurimit është vendimmarrje dhe e Komisionit të Prokurimit Publik si organi më i lartë në fushën administrative të shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorë të ndryshëm. Në DST parashikohet shprehimisht .... Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar Neni 79, neni 80, neni 82 e

*shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

II.5. Në datën 12.04.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 15.04.2022 BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik me pretendimet si më poshtë:

- *Konstatimi i KVO se marrëveshja dhe prokura e posaçme është jo e rregullt është haptazi e paligjshme pasi marrëveshja dhe prokura e posaçme janë plotësisht të rregullta të hartuara konform legjislacionit në fuqi ku përcaktohen kushtet dhe kriteret kryesore për krijimin e një BOE e cila do të shërbejë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 3 pika 3.3 përcaktohet se: Palët bien dakord që të bashkëpunojnë gjatë gjithë aktivitetit të tyre duke bashkërenduar në të gjitha fazat e procedurat e kërkuara nga legjislacioni shqiptar për realizimin e kushteve të kërkuara nga çdo autoritet kontraktues ku ky bashkim operatorësh do të marrë pjesë duke bashkëpunuar gjatë gjithë veprimtarisë në çdo procedurë tenderimi. Gjithashtu në nenin 11 të marrëveshjes së bashkëpunimit përcaktohet: palët bien dakord që të marrin pjesë në çdo procedurë tenderimi të zhvilluar në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj. Palët bien dakord se përqindja e pjesëmarrjes është 80 % për Gega Center GKG dhe 20% për Gega Oil Group sha. Për të gjitha procedurat e prokurimit me objekt blerje karburanti Gazoil Diesel 10 pmp, Benzinë, Naftë për kaldajë për ngrohje.*
- *Sic vihet re pretendimi i AK në lidhje me përqindjen e pjesëmarrësve në bashkim është arbitrar dhe i kundërligjshëm pasi në marrëveshjen e sjellë nga ana e BOE përcaktohet qartë përqindja e tyre e evidentuar në dispozitat e mësipërme të saj.*
- *Marrëveshja e bashkëpunimit të OE i përcakton të gjitha kushtet e kërkuara në DT. Në mënyrë të qartë janë përcaktuar procedurat ku do të marrin pjesë operatorët dhe përqindja e tyre.*
- *Sa më sipër skualifikimi i ofertës sonë është në shkelje të ligjit DT dhe në shkelje të hapur të parimit të një procesi të rregullt ligjor.*

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.790/2 prot datë 15.04.2022 me arsyet e skualifikimit të BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA.

II.8. Me shkresën nr. 2083/12 prot, datë 27.04.2022 protokolluar me tonën me nr. 790/4 prot datë 29.04.2022 dhe K-1216/1 datë 04.05.2022 protokolluar me tonën me nr.790/5 datë 06.05.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga BOE “Gega Center

GKG” & “Gega Oil Group” SHA, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.9. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 457/2022 datë 13.05.2022 ka vendosur:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Gega Center GKG ShPK dhe Gega Oil Group ShA për procedurën e prokurimit E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-19269-02-09-2022, me objekt Loti 2 “Blerje Naftë (Eurodiesel), me fond limit 72,114,844 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 25.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë ShA.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE “Gega Center GKG ShPK dhe Gega Oil Group ShA, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Gega Center GKG ShPK dhe Gega Oil Group ShA.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.10. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve rezulton se në datën 17.05.2022 autoriteti kontraktor ka kryer procesin e rivlerësimit të ofertave me rezultatet si vijon:

- Gega Center GKG& Gega Oil	69,397,486	I kualifikuar
- A&T&Olsi&2A2F-L Oil	71,998,832	I kualifikuar
- Europetrol Durrës Albania	72,114,000	I skualifikuar

II.11. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve rezulton, se në datën 06.06.2022 autoriteti kontraktor ka kryer procesin e rivlerësimit të ofertave me rezultatet si vijon:

- Gega Center GKG& Gega Oil	69,397,486	I skualifikuar
- A&T&Olsi&2A2F-L Oil	71,998,832	I kualifikuar
- Europetrol Durrës Albania	72,114,000	I skualifikuar

II.12. Në datën 06.06.2022 BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të sipërcituar si dhe kriterëve të kërkuara në DST përkatësisht pika 2.13.12 në të cilën është kërkuar... 2.3.12.Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 l dhe 1(një)mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra. Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e

mëposhtëm: a) Për këto mjete që shënohen në regjistra publikë në rastin e pronësisë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit , certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontabilitetit të leshuar nga DPM dhe për mjetet e siguruar me qira, kontratën e qerasë (e vlefshme) shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontabilitetit të leshuar nga DPM . Shënim: Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8. Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit operatori ekonomik Gega Oil sh.a ka deklaruar se disponon mbi 25 automjete autobote furnizimi si dhe posedojmë automjete 5000 litra dhe 1000 litra sipas kërkesave të AK. Me tagrin që i jep legjislacioni në fuqi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbi verifikimin e dokumentacionit të formularit të vetëdeklarimit vijoi me shqyrtimin fizik të dokumentacionit të depozituar nga BO “Gega Oil” sh.a &Gega Center GKG në të cilën konstatohet si më poshtë vijon:

- Në përmbushje të pikës 2.3.12 për lotin 2 bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë dorëzuar mjetet me targa AA604SR me kapacitet 5000 litër(në pronësi të shoqërisë Gega Oil sha) shoqëruar me dokumentacionin përkatës si dhe mjetin me targa AA015BK me kapacitet 1000 litër ( siguruar nëpërmjet kontratës me qira me subjektin Kastrati sha datë 15.02.2022 (i njëjti mjet i depozituar për procedurën e prokurimit me objekt” Blerje benzinë pa plumb” shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Referuar kriterit të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit në të cilën janë kërkuar 2 mjete me kapacitet deri në 1000 litër si dhe 1 mjet me kapacitet deri në 5000 litër KVO konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë paraqitur vetëm 2 mjete (një me kapacitet 1000 litër si dhe 1 me kapacitet 5000 litër). Referuar të gjithë dokumentacionit të depozituar të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, KVO vëren se operatorët ekonomikë nuk kanë arritur të paraqesin dokumentacion për të dëshmuar disponimin e një autoboti tjetër të tretë deri në 1000 l sipas kriterit të kërkuar në DST. Pra, operatorët ekonomikë kanë paraqitur 2(dy) autobote naftë dhe jo 3(tre) autobote ashtu siç është kërkuar në DST.
- Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të

*paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që bashkimi i operatorëve ekonomikë zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me numrin përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.12 të “Kapaciteti teknik”, në dokumentet standarde të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik Gega Center GKG shpk & Gega Oil sha është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar Neni 79, neni 80, neni 82 e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

II.13. Në datën 07.06.2022 dhe 08.06.2022 ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.14. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 09.06.2022 BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik me pretendimet si më poshtë:

- *Kjo pikë në DT është pikë që e cila vjen në kundërshti të plotë me qëllimet dhe parimet e ligjit pasi në mënyrë të qëllimtë formulon një kriter të paqartë dhe jo transparent . Del qartë se karburantin UKT do e marri në formën e tollonave letër ose tollonave elektronik me sistem dhe për këtë arsye pajisja e operatorëve ekonomikë me bote dhe autobote është një kërkesë e paligjshme dhe tërësisht arbitrare. Pika 2.3.12 jo vetëm është një kriter përjashtues por gjithashtu ka probleme në formulimin e saj gjuhësor. Shprehje të tilla si minimumi 2 mjete bëjnë të paqartë totalin e mjeteve që ky AK kërkon për realizimin e kontratës dhe për më tepër që BOE deklaroi që kanë venë në dispozicion mbi 25 mjete. BOE disponon momentalisht mbi 25 mjete të kësaj natyre. Nuk ka arsye logjike dhe ligjore përse ky BOE nuk do të vinte në dispozicion një autobus tjetër në zbatim të kriterit 2.3.12 në qoftë se përshkrimi i tij do të ishte i qartë.*

II.15. Me shkresën nr. 2083/26 prot, datë 20.06.2022 protokolluar me tonën me nr. 1228/3 prot datë 20.06.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga BOE “Gega



Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i saj.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “ *Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të sipërcituar si dhe kriterëve të kërkuara në DST përkatësisht pika 2.13.12 në të cilën është kërkuar.... 2.3.12.Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 l dhe 1(një)mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra. Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: a) Për këto mjete që shënohen në regjistra publikë në rastin e pronësisë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM dhe për mjetet e siguruar me qira, kontratën e qerasë (e vlefshme) shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM . Shënim: Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8. Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit operatori ekonomik Gega Oil sh.a ka deklaruar se disponon mbi 25 automjete autobote furnizimi si dhe posedojmë automjete 5000 litra dhe 1000 litra sipas kërkesave të AK. Me tagrin që i jep legjislacioni në fuqi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbi verifikimin e dokumentacionit të formularit të vetëdeklarimit vijoi me shqyrtimin fizik të dokumentacionit të depozituar nga BO “Gega Oil” sh.a & Gega Center GKG në të cilën konstatohet si më poshtë vijon:*

*Në përmbushje të pikës 2.3.12 për lotin 2 bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë dorëzuar mjetet me targa AA604SR me kapacitet 5000 litër(në pronësi të shoqërisë Gega Oil sh.a) shoqëruar me dokumentacionin përkatës si dhe mjetin me targa AA015BK me kapacitet 1000*

litër ( siguruar nëpërmjet kontratës me qira me subjektin Kastrati sh.a datë 15.02.2022 (i njejt i depozituar për procedurën e prokurimit me objekt” Blerje benzinë pa plumb” shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Referuar kriterit të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit në të cilën janë kërkuar 2 mjete me kapacitet deri në 1000 litër si dhe 1 mjet me kapacitet deri në 5000 litër KVO konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë paraqitur vetëm 2 mjete (një me kapacitet 1000 litër si dhe 1 me kapacitet 5000 litër). Referuar të gjithë dokumentacionit të depozituar të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, KVO vëren se operatorët ekonomikë nuk kanë arritur të paraqesin dokumentacion për të dëshmuar disponimin e një autoboti tjetër të tretë deri në 1000 l sipas kriterit të kërkuar në DST. Pra, operatorët ekonomikë kanë paraqitur 2(dy) autobote naftë dhe jo 3(tre) autobote ashtu siç është kërkuar në DST, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

*2.3.12.Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 l dhe 1(një)mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra.*

*Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

*a) Për këto mjete që shënohen në regjistra publikë në rastin e pronësisë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM dhe për mjetet e siguruar me qira, kontratën e qerasë (e vlefshme) shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM .*

**Shënim:** Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE ankimues në fazën e dorëzimit të ofertave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, kanë dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në këtë formular përkatësisht në seksionin B

Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, BOE ankimues ka deklaruar se disponon mbi 25 autobote furnizimi sipas kërkesave të AK 5000 L dhe 1000L.

III.1.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor ky i fundit sqaron, se në zbatim të vendimit të KPP-së autoriteti kontraktor riklasifikoi ofertat duke e kualifikuar BOE ankimues, si dhe në zbatim të nenit 26/6 të VKM njoftoi BOE ankimues me qëllim depozitimin e dokumentacionit.

III.1.4. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit origjinal të dorëzuar nga BOE Gega Oil” sh.a &Gega Center GKG, pranë autoritetit kontraktor dhe përcjellë nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së më datë 20.06.2022, rezulton se BOE ankimues në përmbushje të kriterit 2.3.12.Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 L dhe 1(një) mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra, ka dorëzuar dokumentacion provues për mjetin me targa AA604SR me kapacitet 5000 L dhe AA015BK me kapacitet 1000 L.

III.1.5. Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- *1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*
- *2.Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
- *3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

III.1.6. Sa më sipër, KPP gjykon se BOE “Gega Oil” SHA & Gega Center GKG SHPK me dokumentacionin e paraqitur në rastin konkret nuk provon se disponon 3 mjete autobot duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.12 të kriterëve të veçanta për kualifikim, ku përcaktohet shprehimisht, se operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 L dhe 1 (një) mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra. Referuar parashtrimeve në ankesë edhe vetë BOE ankimues pranon, se nuk ka dorëzuar dokumentacion për tre mjete me argumentin se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor

është i paqartë. KPP i gjen argumentet e BOE ankimes të pabazuara, pasi kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor nuk shfaq paqartësi dhe konfuzion në rastin konkret. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar në mënyrë të qartë, se operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi **2 mjete (autobot)** me kapacitet mbajtës deri në **1000 L dhe 1(një)** mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në **5000 litra**. Në interpretim literal të kriterit KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka kërkuar 3 mjete në total nga të cilat 2 mjete me kapacitet 1000 litra dhe një mjet me kapacitet 5000 litra. Ndërkohë BOE ankimes edhe pse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në fazën e dorëzimit të ofertave ka deklaruar, se disponon mbi 25 mjete në momentin procedural të dorëzimit të dokumentacionit origjinal për verifikim nga ana e autoritetit kontraktor para shpalljes së tij fitues, ka dorëzuar dokumentacion provues vetëm për dy mjete autobot dhe jo për tre të kërkuara, duke qenë kështu në kushtet e mosplotësimit të kriterit të veçante të kualifikimit.

III.1.7. Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga BOE ankimes nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.8. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik ankimes do të kishte pretendime në lidhje me kriteret/specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1/1 e LPP. Në nenin 110 pika 1/1 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet se "Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda

10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” apo akoma më tej të kërkonte sqarimet e nevojshme lidhur me kriteret në përputhje me nenin 75 të LPP-së. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Sa më sipër pretendimet e BOE “Gega Oil” sh.a &Gega Center GKG SHPK nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Gega Oil” SHA & Gega Center GKG SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-19269-02-09-2022, me objekt Loti 2 “Blerje Naftë (Eurodiesel), me fond limit 72,114,844 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 25.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE “Gega Oil” sh.a &Gega Center GKG SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

## MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Jonaid Myzyri në lidhje me vendimin e shumicës.

Si Kryetar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsytimit të vendimit, e rrjedhimisht dhe dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA për procedurat e prokurimit me, Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga nga BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-19269-02-09-2022, me objekt Loti 2 “Blerje Naftë (Eurodiesel), me fond limit 72,114,844 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 25.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë ShA.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

### Arsyetoj

II.1. Lidhur me pretendimin e BOE “Gega Center GKG” & “Gega Oil Group” SHA, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsytimin se “ *Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të sipërcituar si dhe kriterëve të kërkuara në DST përkatësisht pika 2.13.12 në të cilën është kërkuar... 2.3.12.Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 l dhe 1(një)mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra. Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: a) Për këto mjete që shënohen në regjistra publikë në rastin e pronësisë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM dhe për mjetet e siguruar me qira, kontratën e qerasë (e vlefshme) shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM . Shënim: Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8. Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit operatori ekonomik Gega Oil sh.a ka deklaruar se disponon mbi 25 automjete autobote furnizimi si dhe posedojmë automjete 5000 litra dhe*

1000 litra sipas kërkesave të AK. Me tagrin që i jep legjislacioni në fuqi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbi verifikimin e dokumentacionit të formularit të vetëdeklarimit vijoi me shqyrtimin fizik të dokumentacionit të depozituar nga BO "Gega Oil" sh.a & Gega Center GKG në të cilën konstatohet si më poshtë vijon:

Në përmbushje të pikës 2.3.12 për lotin 2 bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë dorëzuar mjetet me targa AA604SR me kapacitet 5000 litër (në pronësi të shoqërisë Gega Oil sh.a) shoqëruar me dokumentacionin përkatës si dhe mjetin me targa AA015BK me kapacitet 1000 litër (siguruar nëpërmjet kontratës me qira me subjektin Kastrati sh.a datë 15.02.2022 (i njëjti mjet i depozituar për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje benzinë pa plumb" shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Referuar kriterit të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit në të cilën janë kërkuar 2 mjete me kapacitet deri në 1000 litër si dhe 1 mjet me kapacitet deri në 5000 litër KVO konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë paraqitur vetëm 2 mjete (një me kapacitet 1000 litër si dhe 1 me kapacitet 5000 litër). Referuar të gjithë dokumentacionit të depozituar të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, KVO vëren se operatorët ekonomikë nuk kanë arritur të paraqesin dokumentacion për të dëshmuar disponimin e një autoboti tjetër të tretë deri në 1000 l sipas kriterit të kërkuar në DST. Pra, operatorët ekonomikë kanë paraqitur 2(dy) autobote nafte dhe jo 3(tre) autobote ashtu siç është kërkuar në DST, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

II.2. Në shtojcën 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3.12. Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 l dhe 1(një)mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

b) Për këto mjete që shënohen në regjistra publikë në rastin e pronësisë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM dhe për mjetet e siguruar me qira, kontratën e qerasë (e vlefshme) shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikatën e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM.

**Shënim:** Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

II.3.Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- *1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*
- *2.Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
- *3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE ankimues në fazën e dorëzimit të ofertave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, kanë dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në këtë formular përkatësisht në seksionin B Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, BOE ankimues ka deklaruar se disponon mbi 25 autobote furnizimi sipas kërkesave të autoritetit kontraktor 5000 L dhe 1000L.

II.5. Së pari vlerësoj se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se kriteri ka paqartësi nuk qëndron, pasi në mënyrë të shprehur në dokumentet e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka sqaruar se për përmbushjen e kapacitetit teknik operatori ekonomik duhet të disponojë *minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 l dhe 1(një)mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra.* Por, vlerësoj se veprimet e proceduriale të kryera nga autoriteti kontraktor në drejtim të vërtetimit të dokumenteve provues mbi deklaratën për disponueshmërinë e mjeteve, pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor ky i fundit sqaron, se në zbatim të vendimit të KPP-së autoriteti kontraktor riklasifikoi ofertat duke e kualifikuar BOE ankimues, si dhe në zbatim të nenit 26/6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” njoftoi BOE ankimues me qëllim depozitimin e dokumentacionit origjinal në përmbushje të kriterëve kualifikuese. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit origjinal të dorëzuar nga BOE Gega Oil” sh.a &Gega Center GKG, pranë autoritetit kontraktor dhe



përcjellë nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së më datë 20.06.2022, rezulton se BOE ankimues në përmbushje të kriterit 2.3.12.Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 L dhe 1(një) mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra, ka dorëzuar dokumentacion provues për mjetin me targa AA604SR me kapacitet 5000 L dhe AA015BK me kapacitet 1000 L.

Ndërkohë, nga ana tjetër në seksionin B Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, BOE ankimues ka deklaruar se disponon **mbi 25 autobote furnizimi sipas kërkesave të autoritetit kontraktor 5000 L dhe 1000L.**

Ligji i ri i prokurimit publik, ndër risitë e tjera, solli edhe risinë e përmbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit ( disa prej tyre sic përcaktohen në akt nënligjor) me anë të Formularit Përmbledhës të VetëDeklarimit. Ky formular apolikohet me qëllim lehtësimin e operatorëve ekonomikë gjatë procesit të ofertimit është parashikuar përdorimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, i cili i jep mundësi operatorëve ekonomikë ta paraqesin atë si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve, të lëshuara nga palë të treta. Në kuadër të lehtësimit të pjesëmarrjes së operatorëve në procedurat e prokurimit, përveç këtij formulari, parashikohet mundësia që autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë dokumentet mbështetëse në bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, si dhe operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor i ka këto dokumente, pra në rastin kur dokumentet janë të lëshuara nga vetë autoriteti.

Në nenin 82 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. “ Pra, referuar ligjit, fillimisht ekzistonte mundësia që vetë autoriteti të kryente verifikime.*

Në çdo rast, ligji parashikon detyrimin për t’i kërkuar ofertuesit fitues të paraqesë origjinal ose fotokopje të noterizuar: - dokumentet e dorëzuara elektronikisht në një procedurë prokurimi; - dokumentet që mbështesin vetdeklarimet.

Në nenin 26 pika 7 të Vendimit nr.285 datë 19.5.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet ndër të tjera se: *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.* Pra, referuar edhe teknikës legjislative dhe numërimit të pikave të nenit 26, e drejta e autoritetit kontraktor për të kryer verifikime të nevojshme mbi informacionin e deklaruar nga operatori ekonomik shtrihet në **cdo rast**, pra, edhe pas aktit të parë të kërkesës për informacion për të kërkuar sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi deklaratet. Kështu, operatori ka deklaruar që disponon 25 mjete, ndërkohë që ka dorëzuar vetëm 2, ndaj vlerësoj se autoriteti kontraktor duhet të kishte kryer të gjithë veprimet procedurale që ti jepej mundësia që operatorit ekonomik të paraqiste dokumentacion për të provuar deklaratën e tij. Sa më sipër, gjykoj se në kushtet kur BOE

“Gega Oil” SHA & Gega Center GKG SHPK në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar se disponon mbi 25 mjete autobote furnizimi sipas kërkesave të autoritetit kontraktor 5000 L dhe 1000L, autoriteti kontraktor duhet të kishte kryer verifikimet e nevojshme duke kërkuar nga BOE ankimes dokumentacionin origjinal për 25 mjetet e deklaruara. Nga shqyrtimi i rrethanave dhe fakteve të cështjes objekt shqyrtimi nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kryer verifikimet e nevojshme mbi kapacitete e deklaruara nga ankimesi në formularin e vetëdeklarimit. Në rast se operatori ekonomik do të kishte dështuar të provonte deklarimet e tij, atëherë është përgjegjësi e autoritetit kontraktor që në përputhje me nenin 76 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.” Nga shqyrtimi i dosjes nuk konstatoj që të jetë kryer një veprim i tillë procedural.

Gjithashtu, vlerësoj se autoriteti kontraktor duhet të kishte marrë në konsideratë edhe parashikimet e nenit 92 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se; *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”* Risia dhe mënyra e aplikimit të këtij neni është interpretuar edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Ndaj gjykoj se në kushtet e mësipërme nuk mund të shprehem nëse operatori ekonomik e përmbush ose jo kriterin e veçantë të kualifikimit pa u kryer plotësisht veprimet procedurale në përputhje me nenin e mësipërme.

Nuk duhet të harrojmë qëllimin e ligjit të prokurimit publik, si në drejtim të sigurimit të trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë por edhe atë të mirëpërdorimit të fondeve publike dhe shpenzimeve procedurale.

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**